

316.62-053.6:37

Bujar Adili, MA¹

**KOMUNIKIMI ME FËMIJËN – SFIDË E NJË PRINDI TË
EDUKUAR**

**КОМУНИКАЦИЈАТА СО ДЕТЕТО – ПРЕДИЗВИК ЗА
ВОСПИТАНИОТ РОДИТЕЛ**

**COMMUNICATION WITH CHILD – AS A CHALLENGE OF AN
EDUCATED PARENTS**

Abstract

The growth process is highly complex and requires a lot from the child and parents. Parents' moral and intellectual values and their transformation into forms of communication enables to a great extent reducing some negative phenomena in the pedagogical field, antisocial behavior and deviations that causes psychological factors. Recommendations that can help for easier pass this stage lead to the use of unconventional communication methods. As adolescence as specific psycho-physical process, such are the efforts to reduce as much as possible the causes and consequences of negative phenomena that accompany this stage.

Keywords: *communication, child, parent, education*

Abstrakt

Procesi i rritjes është tejet kompleks dhe kërkon shumë edhe nga fëmija edhe nga prindërit. Vlerat morale dhe intelektuale të prindërve dhe shndërrimi i tyre në forma komunikimi mundëson që në masë të madhe të reduktohen disa fenomene negative nga sfera pedagogjike, sjellje asociale dhe devijime që shkaqe kanë faktorët psikologjik. Rekomandimet të cilat mund të ndihmojnë që më lehtë të kalohet kjo fazë çojnë nga shfrytëzimi i mënyrave jokonvencionale të komunikimit. Ashtu siç është specifike adoleshenca si proces psiko-

¹ Magjistër i pedagogjisë, e-mail: bujaradili74@gmail.com

fizik, të tilla janë edhe orvatjet për t'u reduktuar sa më shumë që është e mundur shkaqet dhe pasojat e dukurive negative që shoqërojnë këtë fazë.

Fjalë kyçe: *komunikim, fëmijë, prind, edukim*

Biseda-shkathhtësi kryesore sociale dhe pedagogjike

Komunikimi i shëndoshë është i një rëndësie të veçantë. Problemi është se si të bisedohet dhe të vihet deri në përfundime të caktuara, të sillet tema e caktuar deri në fund, të konsumohet. Kur bëhet fjalë për komunikimin verbal (Haley, 1963) nuk është me rëndësi vetëm ajo çka thuhet, por edhe si thuhet, me çfarë ngjyre zëri, me çfarë toni, me çfarë intensiteti, sepse e gjithë kjo ndikon në përshtypjen përfundimtare e cila lihet te recipienti, pranuesi i mesazhit. Ndonjë kompliment mund të dërgohet me ton tallës, me ç'rast bëhet fjalë për ironi, sarkazëm dhe jo për mesazh që bashkon, gëzon, trimëron.

Në të kuptuarit e komunikimit rol të madh kanë edhe recipientët, të cilët prapëseprapë nga prizmi i tyre përthyejnë mesazhet dhe i interpretojnë në mënyra të ndryshme varësisht nga mendimi që kanë për bashkëbiseduesin, situata e dhënë apo disponimi (von Thun, 1984). Jorrallë ndodh që personi i parë me qëllime më të mira konstaton diçka, kurse këtë personi tjetër ta kuptojë si sulm apo fyerje mbi të, e të mos flasim këtu për keqinterpretimin dhe të ashtuquajturat “zhurma në komunikim” të cilat paraqiten kur komunikantët “nuk flasin me të njëjtën gjuhë”, nuk kuptohen dhe nuk kuptojnë.

Për një komunikim të mirë është me rëndësi:

- ❖ Qartësia në paraqitje, prezentim, ligjërim;
- ❖ Singjeriteti;
- ❖ Qëllimi i shprehur qartë, shkaku dhe caku i bisedës;
- ❖ Konkiziteti;
- ❖ Argumentimi i mirë;
- ❖ Respekti i ndërsjellë;
- ❖ Kontrolli i emocioneve;
- ❖ Empatia etj.

Të dish t'i verbalizosh qëndrimet personale, ndjenjat, mendimet, është parakusht për vendosjen e një komunikimi të mirë me të tjerët. Shpesh ndodh që një person mundohet të thotë çka dëshiron por thjeshtë nuk di t'i bashkërendisë mendimet e tij dhe t'i shpreh ato në mënyrë adekuate. Më pas ai shkon në shpjegime të zgjeruara që sërish i ndikon

se nuk është i shkathtë në koncizitet, shkurtësi dhe një shprehje të kompletuar. Por e gjithë kjo mund të ushtrohet. Si për fillim, personi duhet të jetë i vetëdijshëm për faktin se nuk di mirë t'i verbalizojë mendimet (Lay, 1981) e veta dhe t'i shprehë në mënyrë koncize. Në atë rast më së miri është të provojë që mendimet e tij t'i shpreh dhe transmetojë me shkrim kurse më pastaj të lexojë të shkruarën dhe të vërejë nëse është thënë esenca, cilat fjalë janë të tepërta, a është fjalia e qartë, a mund nga fjalia të dallohet qëllimi dhe mesazhi... Për fat të keq, shumica e personave që kanë probleme të tillë nuk kanë durimin që të ushtrojnë, pra të shkruajnë atë që duan të thonë, sepse të shkruarit është më i ngadalshëm nga të folurit kurse mendimet e tyre edhe ashtu nuk janë të organizuara. Përveç kësaj, pikërisht atëherë kur fillojnë të shkruajnë bëhen të krejtësisht të vetëdijshëm për këtë dhe kjo i dekurajon dhe demotivon.

Mu për shkak të kësaj edhe ndodhin “zhurmat në komunikim”, kur njerëzit nuk dinë qartë të shprehen, të verbalizojnë mendimet e tyre, që mund të irritojë bashkëbiseduesin apo t'i japë atij hapësirë të mjaftueshme për interpretime sipas tij. Deri te zhurma vjen edhe kur të dy komunikantët (ose më shumë) janë nën ngarkim të fortë emocional dhe kjo i pengon që të mendojnë me kokë të çiltër, të ndjekin rrjedhën e mendimeve, të respektojnë bashkëbiseduesin...

Nëse vetëm njëri nga bashkëbiseduesit merr qëndrimin se “vetëm unë jam në të drejtë” atëherë shanset për t'u vendosur një komunikim i mirë janë të vogla. Çdo pjesëmarrës në komunikim duhet t'u lë të tjerëve hapësirë të mjaftueshme që të paraqesin kundër argumentet dhe të lejojë që edhe dikush tjetër të ketë mendim ndryshe (Berne, 1964).

Shikuar nga plani mikrosocial-familja, nëse prindërit dëshirojnë të imponojnë mendimin e vet dhe qëndrimet me çdo kusht, këtë fëmijët do ta ndejnë dhe do të reagojnë ose me tërheqje ose me agresivitet. Çdoherë duhet pasur parasysh se askush nuk e dëshiron imponimin, bindjen, të shprehurit keq, kurse në fakt, ndoshta edhe pa vetëdije, pikërisht këtë e bëjnë të rriturit gjatë komunikimit me fëmijët.

Duhet të jemi të vetëdijshëm se tanimë është pas nesh koha e shtrëngimit, tonit urdhërues, krijimit të respektit nga frika, dënimit të rreptë. Gjeneratat e reja nuk mund të funksionojnë në bazë të parimeve të tilla. Fëmijët sot i dinë të drejtat e tyre dhe duan që të trajtohen me respekt dhe konsideratë nga të rriturit, të dëgjohet edhe zëri i tyre, t'u dëgjohen nevojat, të ndjehen kompetentë, edhe ata të pyeten. Përveç kësaj, çështja e lirisë së zgjedhjes është gjithmonë e hapur dhe nëse rreptësisht ndalohet diçka, kjo nuk do të thotë se me këtë a priori fëmijës

do t'i ndalohet të bëjë diçka në fshehtësi. Me bisedë në kohë mund të arrihen rezultate më të mira se sa me ndalesa dhe dënime. Me rëndësi është që edukantit t'i sqarohet se përse diçka nuk është e mirë për të dhe bashkëmoshatarët e tij, t'i ofrohen shembuj, përvoja të të tjerëve, të pyetet për mendimin e tij, të krijohet atmosferë e besimit, të lihet fëmija që vet të vijë deri në përfundime të caktuara, e jo t'i "servohen" si të gatshme, posaçërisht jo në formë të ndalesave pas të cilave nuk qëndron as edhe një shpjegim racional. Jones dhe Gerard (1981) dallojnë komunikim të rremë, të njëanshëm, reaktiv dhe të dyanshëm. Prandaj komunikimi i shëndoshë në familje është tejet i rëndësishëm sepse më vonë do të jetë bazë për zgjidhjen e shumicës së problemeve që i sjell mosha e një tinxheri.

Si të komunikohet me fëmijën?

Sinqeriteti

Fëmijës qartë t'i tregohet se për çka dhe përse duhet biseduar me të. Të diskutohet haptas brengosja, frika, për këto të flitet haptas por jo në mënyrë patetike. T'i bëhet e qartë fëmijës se si është të qenurit prind. Fëmijët njohin sinqeritetin dhe të qenurit të hapur dhe vetëm në këtë mënyrë do të arrihet që në të njëjtën mënyrë të veprojnë edhe ata.

Besnikëria

Meqë një adoleshent me kujdes të madh sodit gjithçka përreth vetes, menjëherë heton hipokrizinë dhe pabesinë. Duhet të kihet kujdes në lidhje me pikëpamjet dhe veprimet në lidhje me cigaret, alkoolin dhe drogën. Nëse një individ në ditë pi dy kuti cigare dhe nuk dëshiron që fëmija i tij të bëhet duhanpirës, patjetër të pranojë pafuqinë e tij dhe qartë të paralajmërojë fëmijën e vet që të mos i përsërisë gabimet e tij. Qartë dhe haptas duhet thënë se nuk miratohet pirja e duhanit, pirja e alkoolit, marrja e marihuanës dhe ekstasit, dhe kuptohet edhe e të gjitha materieve që shkaktojnë varësi. Për çdonjërin nga këto duhet pasur arsytim të qartë dhe qëndrim të paluhatshëm. Edhe pse edhe sjellja e prindërve ndikon në sjelljen e fëmijëve, është vërtetuar se më të rëndësishëm janë qëndrimet e forta, të qarta dhe kuptimplotë. Kuptohet që këto duhet të jenë mendime dhe qëndrime të të dy prindërve.

Të qenurit të hapur

Komunikimi i hapur kërkon edhe të qenurit të gatshëm për çdo lloj shok situatë (Wood, 2010). Kuptohet që kjo nuk është patjetër të jetë

përdorimi i drogës, por pak a shumë situata të ndryshme të pritura (eksperiencia seksuale, të pranuarit e shfajësimit të rrejshëm për të fjetur jashtë shtëpisë, nota të dobëta etj.). Pa marrë parasysh se ç'hapa do të ndërmerren më vonë, në ato çaste duhet që fortë të çmohet të qenurit të hapur dhe e njëjta edhe të thuhet. Vet akti i pranimit i cili çon kah mundësia e diskutimit, mund të jetë i një rëndësie të veçantë nëse ndodhin gjëra të cilat do të kërkojnë ndihmën e vendosët dhe intervenimin e prindit.

Të dëgjuarit

Të dëgjuarit nuk do të thotë vetëm se informacioni është transmetuar, por edhe se personi është i sigurt se vërtetë është dëgjuar dhe kuptuar drejtë. Duhet treguar se prindi vërtetë ka interesim madje edhe nëse ngjarja nuk i duket edhe aq e rëndësishme. Nëse ekziston komunikim i mirë me fëmijën, dihet mirë se shumë gjëra mund të kuptohen duke dëgjuar për gjërat në shikim të parë jo të rëndësishme por të cilat në të vërtetë janë me rëndësi të madhe për raportet ndërmjet prindit dhe fëmijës në të ardhmen.

Të provohet:

Në vend që: "e ke patjetër...", "duhet të...", "më mirë është për ty që...", se përndryshe...", të thuhet: "çka mendon, si do të...", "unë mendoj se, por të shkojmë të shohim...", "nëse ke argumente, mund të bisedojmë...".

Por të mos flitet: "mos u brengos, unë do ta rregulloj të gjithë atë...", "ti edhe ashtu je budalla...", "ti fare s'je në gjendje të...", në vend të kësaj të provohet me: "ajo s'qe edhe aq mirë, por mendohu...", "mendoj se ti do të mundje ta provoje atë...".

Dhe të mos harrohet se edhe fëmijës së vet prindi mund t'i thotë: "Më fal, unë s'kam qenë në të drejtë", por mund t'i thotë edhe: "E di se e kam tepruar. Por kjo është sepse të dua fortë dhe shumë frikohem për ty" – dhe fëmijët dhe të rinjtë këtë të folur e kuptojnë.

Në çka prindërit duhet të kenë kujdes në fazën adoleshente të fëmijës:

- ❖ Nuk janë të gjithë fëmijët në faza të njëjta të zhvillimit fizik dhe psikik.

- ❖ Duhet pasur kujdes në sjelljen dhe raportet që fëmija të mos lëndohet dhe të mos ekspozohet në tallje të paqëllimtë.

❖ Edhe pse konsiderohet se të rinjtë gjithmonë janë pa brenga dhe të lumtur, faza e pjekurisë sjell edhe ndjenja të vetmisë dhe turp të cilat duhet të vërehen.

❖ Konsiderohet se numri i të rinjve me prirje nga simptomat e depresionit vjen duke u rritur.

❖ Për ndërtimin e vetërespektit ndonjëherë është i patjetërsueshëm edhe rebelimi dhe vetëbesimi jo i arsyeshëm, e këto duhet vërejtur dhe ndaj tyre të mos vijë në shprehje të përgjigjurit me agresivitet.

❖ Dhënia e rezistencës nuk është gjithmonë negative, por agresiviteti që kufizohet me sjellje antisociale kërkon reagim të shpejtë dhe efektiv.

A ka mënyrë që të kuptoni se vallë merr drogë fëmija juaj?

Pasi që në adoleshencë ndryshimi i disponimit është më shumë rregull se përjashtim, e drejta e privatësisë dhe të “informacioneve sekrete të tij” janë tejet të theksuara kurse kërkesat për pavarësi burim permanent i zënkave latente, nuk mund që me siguri të madhe të thuhet cilat shenja janë pjesë “normale” të rritjes dhe cilat çojnë nga shenjat e marrjes së materieve të varësisë (Thomson, 1998). Për fat të keq, sipas raporteve të shërbimeve kompetente mund të kuptohet se jo rrallë shenjë e parë se diçka ndodh për prindërit është kur adoleshentit të tyre i është përkeqësuar gjendja duke qenë në banjo për shkak të drogës jo të pastër ose nga mbidoza. Disa nga këto shenja do të duhej patjetër që prindin ta detyrojnë të reagojë, madje edhe nëse nuk është në pyetje droga por një krizë më serioze e adoleshencës nëpër të cilën kalon fëmija:

- ❖ Ndryshim momental dhe i shpeshtë i disponimit;
- ❖ Shprehje e papritur e mllefrit;
- ❖ Tjetërsim më i madh e më i madh nga ndodhitë e përditshmërisë familjare;
- ❖ Ndërrimi i rrethit të shokëve;
- ❖ Probleme në shkollë (notat, mungesat);
- ❖ Mungesa nga aktivitetet jashtëshkollore;
- ❖ Shmangia e përgjigjeve se ku dhe me kë shoqërohet dhe lëviz;
- ❖ Nevoja sa më e madhe për para;
- ❖ Ndryshimi i oreksit dhe mënyrës së të ushqyerit;
- ❖ Harresa;
- ❖ Zhdukja e gjërave (ose parave) nga shtëpia;
- ❖ Të kuptuarit apo padia për ndonjë vjedhje;

❖ Letra të vogla, gota, lugë, fletë të holla alumini, pambuk i pistë diku në dhomë;

Parakushtet për dialog të hapur me fëmijën

Gatishmëria e prindërve që gjithmonë të bisedojnë me fëmijët, t'i dëgjojnë, të orvaten t'i kuptojnë arsyetimet dhe dyshimet e tyre, është parakusht i shkëlqyeshëm për besim dhe respekt reciprok.

Në qoftë se prindërit gjatë bisedës përparësi u japin fëmijëve, pra shprehin gatishmëri që t'i dëgjojnë, të kuptojnë arsyet dhe argumentet me të cilat mbështesin qëndrimet e tyre ose arsyetojnë sjelljet, me atë u dërgojnë porosi se marrin në konsideratë mendimin e tyre, që do të thotë se të njëjtën e presin edhe prej tyre. Përveç kësaj, ballafaqimi i argumenteve të dy palët i mëson që me pjekuri të mendojnë për veprimet e veta dhe të bëjnë zgjedhje të mirë, i mëson në drejtësi dhe vështrimin e problemeve nga disa kënde. Nga kjo del një parakusht për komunikim të suksesshëm: empatia (Thomson, 1998). Duhet provuar “të hyhet në lëkurën e tjetrit” për të pasur mirëkuptim të mjaftueshëm për të tjerët dhe për të marrë parasysh edhe motivet e tyre, nevojat, rrethanat, sepse nëse fokusi bie vetëm mbi arritjen e qëllimit vetjak dhe nuk shihen të tjerët, atëherë ngulfatet komunikimi dhe nuk lejohet që ai të zhvillohet në interes të të gjithëve, që të vihet deri në përfundime dhe zgjidhje të caktuara.

Të komunikuarit është aktivitet reciprok verbal (dhe joverbal) i dy ose disa pjesëmarrësve në të cilin nuk ka fitues dhe humbës, dhe aq më pak do të duhej të kishte të lënduar. Për fat të keq, duke filluar nga familja e deri te rrethi i ngushtë dhe i gjerë, ndodh shpesh që pas bisedës ndonjëri të mbetet i lënduar. Kjo më së shpeshti ndodh kur njëri palë i imponohet mendimi, ndalesa ose qëndrimi personal. Ky më parë do të quhej monolog se sa dialog, monolog nga i cili pjesëmarrësi pasiv del i lënduar sepse nuk i është dhënë shansi të thotë diçka në vetëmbrojtje. Forma të tilla të komunikimit zgjasin shkurtë dhe nuk japin rezultate.

Sa më shumë të insistohet që gjatë komunikimit “puna të sillet nga fundi” (Thomson, 1998), kjo është ajo e suksesshmja, në veçanti nëse në temën e caktuar konsumohen të gjithë argumentet. Është me rëndësi që komunikuesit t'i përmbahen temës së diskutimit, të mos bëjnë digresione të cilët mund t'i shpijnë në drejtim krejtësisht të kundërt. Dhe gjithsesi, të jenë maksimalisht të sinqertë, të pranojnë gabimet, të mos fshehin asgjë, të dinë të pranojnë vetveten e jo me çdo kusht

të japin pasqyrë për veten të tillë siç do të dëshironin të duken para të tjerëve: të fortë, të pamposhtshëm, çdoherë në të drejtë.

Nëse gjatë komunikimit vetëm njëri nga pjesëmarrësit nuk luan ndershëm, kjo me automatizëm do të thotë se me të njëjtat mjete do të shërbehet edhe tjetri dhe kjo do të vijë në shprehje madje në bisedën e parë të radhës. Prandaj është me rëndësi që prindërit edhe në këtë segment të rëndësishëm edukativ të jenë model për fëmijët e vet dhe që nga të vegjël t'i mësojnë si të bisedojnë dhe me të t'i përgatisin për të komunikuar në shkollë, më vonë në punë dhe në shoqëri në përgjithësi.

Nëse të rriturit vërejnë se nuk posedojnë shkathhtësi komunikuese, sepse për fat të keq këto nuk mësohen në suaza të arsimit formal, ndihmë dhe këshilla duhet të kërkojnë nga pedagogu dhe psikologu, pa mëdyshje, sepse kjo është në të mirën e tyre dhe familjes së tyre, miqve dhe bashkëpunëtorëve të biznesit.

Që të vihet deri te një bisedë e hapur ndërmjet prindit si edukator dhe fëmijës, është me rëndësi që të kihet parasysh:

❖ Të zgjedhet koha më e mirë për bisedë në veçanti nëse bëhet fjalë për temë serioze. Pra, nuk mund të bisedohet çiltër kur njëri nga pjesëmarrësit në komunikim është i lodhur, i frustruar, i zemëruar, nervoz, i përgjumur. Prindërit duhet vlerësuar se kur është momenti më i përshtatshëm për të filluar bisedën për “tema të rënda” me fëmijën e vet, gjithsesi jo menjëherë pasi është zgjuar nga gjumi, sapo ka ardhur nga shkolla ose mu para fjetjes. Gjatë ditës biseda mund të fillojë spontanisht, pa ndonjë paralajmërim frikësues paraprak të tipit: Duhet seriozisht të bisedojmë!!! Dëgjo, kam diçka me rëndësi për të të thënë!... Kjo vetëm mund të frikësojë fëmijën dhe me automatizëm vështirëson të komunikuarit e mëtejshëm.

❖ Me rëndësi është edhe vendi se ku zhvillohet biseda. Fëmijët kanë nevojë për intimen e vet, nuk mund të pritët nga fëmija që të jetë i koncentruar në bisedë në prani të vëllait apo motrës, gjyshes, gjyshit, fqinjit etj. E njëjta vlen edhe për TV-në e kyçur në veçanti në kohën kur jepet emisioni i tij i preferuar. Më mirë është që me fëmijën të bisedohet në vendin e tij më të dashur p.sh.: në dhomën e tij, në këndin e punës, në këndin e lojës. Rast i shkëlqyeshëm për bisedë është edhe shëtitja nëpër rrugë të gjëra ku nuk ka shumë kalimtarë... Do të ishte mirë që së paku një ditë në javë të jetë “e rezervuar” për shoqërim pa obligime dhe diskutim me fëmijën nën shoqërimin e ëmbëlsirave, çokolletës së nxehtë, pijes së preferuar, qoftë në shtëpi apo në ëmbëltore. Më vonë ky do të mund të jetë rast i mirë për bisedë.

❖ Të pyetet fëmija për mendimin e tij, qëndrimin për temën e dhënë, të tregojë përvojën e tij ose të moshatarëve, çka është shkaku i ndonjë dukurie, çka propozon, si e sheh veten në një situatë të dhënë etj. Është vërtetuar se bisedat “preventive” në fakt kanë parandaluar fëmijën që më vonë të silltet në mënyrë të papërshtatshme. Me rëndësi është që të fëmija të zhvillohet qëndrimi kritik, vendosmëria dhe sensi për dallimin e të mirës dhe të keqes, por edhe individualiteti, në mënyrë që të mos nënshtrohet nga ndikimi i moshatarëve dhe trendeve shoqërore.

❖ Gjatë bisedës, te prindërit është me rëndësi gjakftohtësia, qetësia, shprehja e butë në fytyrë, atmosfera e sigurisë dhe besimit, sinqeriteti, gatishmëria që të pranohet mendimi i fëmijës madje edhe nëse s’është ashtu siç thotë ai, të qenurit i hapur ndaj shumëllojshmërisë, qasja pa ngut dhe me nge.

❖ Me rëndësi është edhe pozicioni i trupit, kontakti vizual me fëmijën, lëkundja me kokë derisa fëmija flet, prekja, përqafimi, gjithçka varet nga situata (Robins, 1989).

Këto janë kohëra të vështira për edukim në frymën e vlerave universale por kjo assesi nuk duhet të jetë justifikim për zvogëlim të komunikimit me fëmijët, por përkundrazi, sfidë për zotësi edukuese.

Komunikimi joverbal në dialogun me fëmijën

Komunikimi joverbal është pjesë e pashmangshme e çdo komunikimi, po ashtu edhe e bisedës me fëmijën. Çdo prind duhet vet të investigojë shenjat joverbale të fëmija i vet, ta njohë dhe ta ndjekë se si silltet kur është i zemëruar, i shqetësuar, pa brenga, kur fsheh ndonjë sekret etj.

Sipas shumë kërkimeve, 70% e komunikimit të përgjithshëm bie në komunikimin joverbal. Në shikim të parë kjo duket një përqindje e madhe por kur të analizohet qoftë dialogu apo monologu, fjalët e folura në fakt mbështeten në shprehje të ndryshme të fytyrës (ekspresioni facial), lëvizje të duarve (gjestikulimi), lëkundja e kokës, pozicioni i trupit... (Wood, 2010).

Në komunikim joverbal gjatë bisedës bën pjesë edhe shikimi, madje edhe ngjyra dhe intensiteti i zërit futet në suaza të komunikimit joverbal, sepse i jep konotacione të ndryshme asaj që thuhet. Pse në dialogun me fëmijën është me rëndësi të ndiqen edhe këto detaje të cilët në shikim të parë nuk janë të rëndësishëm, por prapëseprapë në masë të madhe përcaktojnë rrjedhën e të kuptuarit ndërmjet bashkëbiseduesve?

Nga perspektiva e prindit:

❖ Është me rëndësi që t'i kushtohet kujdes asaj nëse fëmija kur i drejtohet prindi, shikon në dysheme, shëtit shikimin nëpër dhomë ose shikon me frikë. Në rastin e parë, nëse e qortoni, kjo do të ishte shenjë se se ka gabuar, se pendohet dhe i vjen keq për atë që ka bërë. Në rastin e dytë, nuk ka dert për çka i flitet, është i paineresuar, në njërin vesh i hy kurse në tjetrin i del e gjithë ajo që i thuhet. Nëse shikon me frikë, ky është mesazh që të zbutet toni me të cilin flitet sepse frikësohet dhe të trimërohet të thotë se përse ka fshehur diçka dhe a shpreh pendim.

❖ Shikimi i fëmijës është i rëndësishëm për të vërtetuar nëse fëmija e flet të vërtetën. Shikimi i hapur lë të kuptohet se fëmija s'ka gjë me ligësinë derisa dridhja e syve dhe lëvizja e tyre është një tregues se diçka fsheh edhe pse nuk do të pranojë atë.

❖ Shprehja e fytyrës po ashtu është me rëndësi të ndiqet: fytyra e mërrolur dhe e zemëruar duhet të jetë shenjë se fëmija nuk miraton atë për të cilën i flitet dhe ndoshta është më mirë të fillohet me bisedë më të relaksuar për të ardhur deri te zgjidhja e problemit. Nëse insistohet në gjithë këtë, mund të ndodh që fëmija ende më shumë të distancohet dhe të kalojë në fazën e të dëgjuarit pasiv: shtiret se dëgjon kurse në të vërtetë fjalët që i thuhet nuk prekin në vetëdijen e tij, që gjithsesi është një formë nga më të rëndat në moskuptimin e bashkëbiseduesit.

❖ Nëse fëmija ka shprehje të habitë në fytyrë, sy të hapur, vetulla të ngritura dhe gojë gjysmë të hapur, kjo do të thotë se ai nuk kupton për çka i flitet, prandaj ky mund të jetë tregues se ai në fakt s'ka fshehur gjë por se frikohet që atë ta thotë në mënyrë që të mos shkaktojë zemërim ende më të madh te bashkëbiseduesi. Është me rëndësi që para se të "sulmohet" fëmija për ndonjë çapkëneri, t'i kërkohet që të deklarohej nëse e ka bërë atë dhe pse. Shumë shpesh kjo "pse-ja" është e një rëndësie vendimtare sepse shkakun e sjelljes së keqe të fëmijës në masë të madhe e përcakton raporti i tij me të tjerët dhe se nëse zbulohet, mund të jetë një arsye për një sjellje të tillë. Në atë rast, prindërit nuk duhet t'i arsyetojnë dhe privilegjojnë fëmijët, por t'ua mësojnë teknikën e kontrollit të emocioneve dhe mënyrat e reagimit si për shembull në provokimet nga të tjerët.

❖ Nëse shpatullat e fëmijës janë të ngritura, kjo do të thotë se ai është nën tension, në ngërç dhe në situata të tilla është me rëndësi që fëmija të lirohet nga tensioni, t'i flitet butë, të ledhatohet, t'i mbillet besim në mënyrë që të jetë gati për bisedë.

❖ Me rëndësi është të vëzhgohet pozita e duarve të fëmija, a i kërcet gishtat, a i ka duart të kryqëzuara në gjoks që është shenjë e refuzimit dhe distancës, në ç'pozitë është trupi, a është në ngërç apo fëmija është nën tension dhe i gatshëm për “sulmin”.

❖ Nëse fëmija gjestikulon derisa rri ulur, kurse prindi orvatet të bisedojë me të, me rëndësi është të largohet i gjithë tensioni, ndoshta të merret fëmija në krah nëse është i vogël, të kapet për dore dhe në çfarëdo qoftë mënyre të realizohet kontakt fizik, ashtu që fëmija të koncentrohet në atë që i flitet ose pyetet (Wood, 2010).

Nga perspektiva e fëmijës:

❖ Prindërit nuk duhet të mendojnë se fëmija i tyre nuk i vëzhgon se si sillen gjatë bisedës. Nuk duhet harruar se çdo lëvizje e prindit, intensiteti i zërit, pozita e trupit, e tëra kopjohet dhe kjo më vonë do të tregohet në komunikimin e tij me bashkëmoshatarët ose në lojë me lojërat e tij. Jorrallë ndodh që nëse prindërit vazhdimisht qortojnë fëmijët e vet, mandej fëmijët agresivitetin e tillë verbal do ta manifestojnë te kukullat e tyre, merimangat, arushat... Në disa raste të vëllain apo motrën e vogël, shokun nga çerdhja, shokun e klasës etj. Modelet e sjelljes fëmijët adoptojnë kryesisht nga prindërit e tyre.

❖ Fëmija ndjen pasigurinë e prindit gjatë komunikimit sado që të insistojë që prindi të fsheh atë, prandaj është me rëndësi të dihet se çka dëshirohet të arrihet nëpërmjet bisedës me fëmijën.

❖ Edhe për fëmijën si komunikant është me rëndësi shikimi, shprehja e fytyrës, qëndrimi... Duhet orvatur që edhe në zemërimin më të madh të mos hetohet fytyra e frikshme e cila do të frikësonte fëmijën, i cili në atë do të reagoonte me tërheqje deri sa është i vogël dhe me agresivitet dhe rezistencë kur të rritet. Është me rëndësi që vet prindi paraprakisht të qetësohet dhe pastaj të bisedojë me fëmijën.

❖ Me rëndësi është që me fëmijën të mos bisedohet vetëm atëherë kur ka kërcitur diçka. Duhet insistuar që dialogu me fëmijën të mos silltet vetëm rreth situatave jo të këndshme, kritikave, qortimeve etj. por me fëmijën të bisedohet edhe për temat që janë interesante për të.

❖ Duhet insistuar që gjatë bisedës me fëmijën prindi të mos ketë shprehje të brengosur të fytyrës, por të çiltër, ndonjëherë kureshtare, me çka fëmijës i jepet të kuptojë se prindi interesohet edhe për mendimin e tij, qëndrimin e tij mbi temën e caktuar, nëse nuk është harruar (asesi të mos harrohet) të pyetet: E çka mendon ti për këtë? (Kratz, 2005).

Sikurse në gjithçka, ashtu edhe gjatë të komunikuarit me fëmijët, por edhe me të rriturit, nuk ekziston një recetë unike në bazë të

të cilit do të silleshin prindërit, sepse po të ekzistonte, atëherë kjo do të thotë se ata janë robotë e jo njerëz me ndjenjat e veta, qëndrime dhe sistem vlerash (Knapp dhe Vangelis 2009). Prandaj është e rëndësishme që çdo prind vet të hulumtojë shenjat joverbale të fëmijës së vet, ta njohë dhe ndjek se si sillet kur është i zemëruar, i brengosur, i shkujdesur, i pafajshëm, kur ka gabuar diçka etj. Këtu patjetër duhet marrë parasysh dallimet individuale ndërmjet të gjithë nesh nga të cilët më së shumti varet sjellja jonë e përgjithshme dhe funksionimi në grup.

Përfundim

Edukimi i një fëmije nuk është një proces i lehtë dhe çdo herë rezultativ dhe nuk mbaron te prindi, por përkundrazi, pikërisht aty edhe fillon. Është komunikimi ai që ndikon në formimin e fëmijës si personalitet relativisht stabil në veçanti në 5 vitet e para, qasja e prindërve ndaj tij, predispozitat, aftësitë, shkathtësitë dhe kapacitetet individuale të tyre, pozita sociale dhe sfondi intelektual. Prandaj, një prind i edukuar është fillim i mirë për një fëmijë por jo dhe garanci për jetë të mbarë të tij nëse nuk përfillet nevoja e një komunikimi të shëndoshë ndërmjet tyre.

Conclusion

Educating a child is not an easy process, always with good results and does not stop at the parent, but on the contrary, there just begins. Communication is one that affects the formation of the child as a relatively stable personality in particular in the first 5 years, parental approach to him, predispositions, abilities, skills and their individual capacities, social position and intellectual background. Therefore, an educated parent is a good start for a child but not a guarantee for success in his life if is not complied with the need for a healthy communication between them.

Referencat

- Berne, E. (1976). *What do you say after you say hello?*, New York: Bantam.
- Borisoff, D., Victor, D. A. (1989). *Conflict management*, New Jersey: Prentice Hall.
- Haley, J. (1987). *The common denominator interaction*, Munich: Pfeiffer.

Knapp, M. L., Vangelis, A. L. (2009). *Interpersonal Communication and Human Relationships* (6th Edition)

Kratz, H. G. (2005). *Feedback*, Offenbach: Gabal.

Robins, S. P. (1989). *Training in interpersonal skills*, Englewood. Cliffs: Prentis Hall.

Schulz von Thun, F. (2004). *Klarkommen mit sich selbst und anderen: Kommunikation und soziale Kompetenz. Reden, Aufsätze, Dialoge*. Reinbek: Rowohlt.

Thomson, P. (1998). *Tajna komunikacije. Budite uvjerlivi i uspjet ćete*. Zagreb: Barka.

Wood, J. T. (2010). *Interpersonal Communication*. Wadsworth: Cengage Learning.